



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 141

Tiranë – E hënë, 13 shtator 2021

## PËRMBAJTJA

|                                                                      | Faqe                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 544, datë 30.8.2021            | Për ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “FMAA” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale..... 13755                                                  |
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 545, datë 30.8.2021            | Për licencimin e shoqërisë “Agjencia e Administrimit Kolektiv <i>Faber Collective Phonogram</i> ” në administrimin kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit..... 13755                                         |
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 546, datë 30.8.2021            | Për ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “A.K.D.I.E” në administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues..... 13756                                                                                 |
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 547, datë 30.8.2021            | Për ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “Albautor” në administrimin kolektiv në fushën e të drejtave të autorit, për veprat muzikore me apo pa tekst..... 13756                                                                  |
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 551, datë 31.8.2021            | Për moslicencimin e shoqatës “Transmetuese radiotelevizive kabllor valor (RrTL)” në administrimin kolektiv të të drejtave në fushën e prodhuesve dhe të autorëve të audiovizualitetit, organizatat transmetuese “OSHMA”..... 13757 |
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 552, datë 31.8.2021            | Për mosripërtëritjen e licencës së shoqatës “GRAMM-A” si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e mbajtësve të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe të videogrameve..... 13757                                         |
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 553, datë 31.8.2021            | Për mosripërtëritjen e licencës së shoqërisë “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve ‘AMP’” për administrimin kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe të prodhuesve të fiksimeve të para të filmave..... 13758      |
| Vendim i Komisionit të Ndihmës<br>Shtetërore nr. 103, datë 19.7.2021 | Autorizim i ndihmës shtetërore “Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes”..... 13758                                                                                                                                        |

|                                                                   |                                                                                                                                                                                                    |       |
|-------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 440, datë 10.9.2021 | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, znj. Mimi Pjetër Kodheli.....                   | 13760 |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 441, datë 10.9.2021 | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Durrës, z. Denis Mehmet Deliu.....                      | 13762 |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 442, datë 10.9.2021 | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Fier, znj. Mirela Llambro Pitushi.....                  | 13764 |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 443, datë 10.9.2021 | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, qarku Lezhë, znj. Elda Artan Hoti..... | 13765 |
|                                                                   | Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Gardelina Gafko.....                                                                                                 | 13766 |



## URDHËR

Nr. 544, datë 30.8.2021

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË  
SHOQËRISË “FMAA” NË  
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË  
DREJTAVE TË AUTORËVE NË  
FUSHËN E KINEMATOGRAFISË DHE  
TË VEPRAVE TË TJERA  
AUDIOVIZUALE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

## URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “FMAA” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale”.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS  
Elva Margariti

## URDHËR

Nr. 545, datë 30.8.2021

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“AGJENCIA E ADMINISTRIMIT  
KOLEKTIV *FABER COLLECTIVE*  
*PHONOGRAM*” NË ADMINISTRIMIN  
KOLEKTIV NË FUSHËN E TË  
DREJTAVE TË PRODHUESVE TË  
FONOGRAMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

## URDHËROJ:

1. Licencimin e “Agjencisë së Administrimit Kolektiv *Faber Collective Phonogram*”, si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS  
Elva Margariti



## URDHËR

Nr. 546, datë 30.8.2021

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË  
SHOQËRISË “A.K.D.I.E” NË  
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË  
DREJTAVE TË ARTISTËVE  
INTERPRETUES DHE EKZEKUTUES**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

## URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “A.K.D.I.E” në administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I KULTURËS  
Elva Margariti**

## URDHËR

Nr. 547, datë 30.8.2021

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË  
SHOQËRISË “ALBAUTOR” NË  
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV NË  
FUSHËN E TË DREJTAVE TË  
AUTORIT, PËR VEPRAT MUZIKORE  
ME APO PA TEKST**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

## URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “Albautor” si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve për veprat muzikore me apo pa tekst.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I KULTURËS  
Elva Margariti**



## URDHËR

Nr. 551, datë 31.8.2021

**PËR MOSLICENCIMIN E SHOQATËS  
“TRANSMETUESE RADIOTELEVIZIVE  
KABLLOR VALOR (RrTL)” NË  
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË  
DREJTAVE NË FUSHËN E  
PRODHUESVE DHE TË AUTORËVE TË  
AUDIOVIZUALITETIT, ORGANIZATAT  
TRANSMETUESE “OSHMA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, kërkesës së shoqatës “Transmetuese radiotelevizive kabllor valor (RrTL)” nr. 3704 prot., datë 16.7.2021, “Për licencimin si agjenci e administrimit kolektiv, për kategorinë e të drejtave në fushën e prodhuesve dhe të autorëve të audiovizualitetit, organizatat transmetuese “OSHMA”, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”:

## URDHËROJ:

1. Moslicencimin e shoqatës “Transmetuese radiotelevizive kabllor valor (RrTL)” në fushën e prodhuesve dhe të autorëve të audiovizualitetit, organizatat transmetuese “OSHMA”.

2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

3. Kundër këtij urdhri, kërkuar ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS  
Elva Margariti

## URDHËR

Nr. 552, datë 31.8.2021

**PËR MOSRIPËRTËRITJEN E LICENCËS  
SË SHOQATËS “GRAMM-A” SI AGJENCI  
E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË  
FUSHËN E MBAJTËSVE TË TË  
DREJTAVE TË PRODHUESVE TË  
FONOGRAMEVE DHE TË  
VIDEOGRAMEVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, kërkesës nr. 3714 prot., datë 16.7.2021, të organizatës për administrimin kolektiv dhe mbrojtjen e të drejtave të prodhuesve të fonogramëve dhe të videogramëve “GRAMM-A”, “Për ripërtëritjen e licencës si Agjenci e Administrimit Kolektiv”, si dhe legjislacionit në fuqi për “Për organizatat jofitimprurëse”,

## URDHËROJ:

1. Mosripërtëritjen e licencës për organizatën “GRAMM-A” për administrimi kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramit dhe të videogramit.

2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

3. Kundër këtij urdhri, kërkuar ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS  
Elva Margariti

**URDHËR**

Nr. 553, datë 31.8.2021

**PËR MOSRIPËRTËRITJEN E LICENCËS  
SË SHOQËRISË “AGJENCIA E  
MBROJTJES SË PRODUCENTËVE  
‘AMP’” PËR ADMINISTRIMIN  
KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË  
PRODHUESVE TË FONOGRAMAVE  
DHE TË PRODHUESVE TË FIKSIMEVE  
TË PARA TË FILMAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’”, të ndryshuar, të kërkesës së shoqërisë “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve ‘AMP’” nr. 3696 prot., datë 16.7.2021, “Për ripërtëritjen e licencës si agjenci e administrimit kolektiv, për kategorinë e të drejtave të prodhuesve të fonogramit dhe të prodhuesve të fiksimeve të para të filmave”, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

**URDHËROJ:**

1. Mosripërtëritjen e licencës për shoqërinë “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve ‘AMP’” në administrimin kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramit dhe të prodhuesve të fiksimeve të para të filmave.

2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

3. Kundër këtij urdhri, kërkuar ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I KULTURËS  
Elva Margariti**

**VENDIM**

Nr. 103, datë 19.7.2021

**AUTORIZIM I NDIHMËS  
SHTETËRORE “PËR FUQIZIMIN E  
GRAVE DHE NXITJA E  
SIPËRMARRJES”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

|                     |           |
|---------------------|-----------|
| znj. Anila Denaj    | kryetare; |
| znj. Mimoza Dhëmbi  | anëtare;  |
| znj. Etleva Haka    | anëtare;  |
| znj. Mirjana Zisi   | anëtare;  |
| z. Ahmet Mançellari | anëtar.   |

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 19.7.2021, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’” dhe VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’” mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes.

**I. Procedura**

1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 24957, datë 22.6.2021 në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 172, datë 21.12.2020, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021–2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”.

**II. Përshkrimi i masës**

2. Objektivi: plani i ndihmës ka si objekt mbështetjen e grave kandidate, me një ide të qartë për aktivitetin e tyre, për fillimin ose zgjerimin e një biznesi të vogël ose shumë të vogël dhe në territorin e Bashkisë së Tiranës.

3. Baza ligjore e njoftimit të planit: Planin e ndihmës shtetërore është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës 172, datë 21.12.2020, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021–2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”, në vlerën gjithsej 10.000.000 lekë.



4. Kohëzgjatja: plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2021–2022.

5. Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. Përfituesit: përfitues janë gratë sipërmarrëse që synojnë fillimin ose zgjerimin e biznesit të pavarur të vogël ose shumë të vogël, që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Bashkisë së Tiranës.

7. Shtrirja territoriale: projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

8. Forma dhe vlera e ndihmës: vlera e ndihmës shtetërore për vitin 2021 është 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë e Tiranës. Çdo përfitues do të mbështetet në shumën 500,000 lekë (pesëqind mijë) lekë.

### III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup> përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Bashkia e Tiranës ka njoftuar planin e ndihmës shtetërore, i cili lidhet me aktivizimin e burimeve shtetërore në formën e grantit, me qëllim mbështetjen e disa (20) ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e Bashkisë. Planin e ndihmës së njoftuar ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se përmirëson situatën ekonomike të disa ndërmarrjeve në treg.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

### IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në bazë të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”, neni 12 “Ndihmë për ndërmarrje të vogla të sapokrijuara nga sipërmarrëset femra”, sipas së cilës skemat e ndihmës shtetërore në favor të ndërmarrjeve të vogla të krijuara nga sipërmarrëse femra lejohen nëse plotësohen kushtet e këtij neni, si edhe kushtet e kreut III si më poshtë:

- transparencë e ndihmës;
- efekti nxitës i ndihmës shtetërore;
- për qëllim të llogaritjes së intensitetit të ndihmës dhe kostove të pranueshme, të gjitha vlerat e përdorura, janë ato të llogaritura para zbritjes së taksave apo detyrimeve të tjera;
- shuma totale e ndihmës shtetërore e dhënë në favor të aktivitetit, projektit ose ndërmarrjes nuk i kalon 7,5 milionë euro për ndërmarrje; dhe

<sup>1</sup> Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës

së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare”.



- dhënësi i ndihmës shtetërore merr masa të publikojë në faqen zyrtare të internetit të dhënat e skemës.

15. Bashkia e Tiranës, nëpërmjet planit të njoftuar të ndihmës, plotëson kushtet e sipërcituara, duke qenë se:

- skema e ndihmës do të jepet në formën e granteve;

- ndihma konsiderohet të ketë efekt nxitës duke qenë se përfituesi do të dorëzojë një aplikim me shkrim për ndihmën shtetërore pranë dhënësit të ndihmës shtetërore, para kryerjes së shpenzimeve për kryerjen e aktivitetit;

- kostot e pranueshme do të shoqërohen me dokumente justifikuese, të cilat janë të qarta, specifike dhe të përditësuara;

- shuma totale e ndihmës shtetërore, e dhënë në favor të aktivitetit, projektit ose ndërmarrjes nuk i kalon 7,5 milionë euro për ndërmarrje, çdo ndërmarrje do të përftojë 500 000 lekë.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe kushteve të kreut II dhe të nenit 12 të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe nenin 12, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”,

#### VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit për “Fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes”, të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 172, datë 21.12.2020, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021–2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”.

2. Bashkia e Tiranës të sigurojë, se:

- intensiteti i ndihmës shtetërore nuk do të

kalojë 15% të kostove të pranueshme të shkaktuara gjatë 5 viteve të para të krijimit të ndërmarrjes;

- ndërmarrjet e vogla të kontrolluara nga aksionarët e ndërmarrjeve që janë mbyllur në 12 muajt e fundit nuk mund të përfitojnë nga ndihma;

- do të publikojë në faqen zyrtare të internetit informacionin përmbledhës të referuar në formatin e standardizuar të përcaktuar në shtojcën I ose linkun e informacionit, sipas parashikimeve të nenit 9 të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Anila Denaj

#### VENDIM Nr. 440, datë 10.9.2021

#### PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU TIRANË, ZNJ. MIMI PJETËR KODHELI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,



## VËREJ:

Me shkresën nr. 1841/1 prot., datë 10.9.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes, të znj. Najada Fatosh Çomo, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara më datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyeshen në zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 18 (tetëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, janë:

Numri rendor 1 (një) znj. Luljeta Vasil Bozo, numri rendor 2 (dy) znj. Najada Fatosh Çomo, numri rendor 3 (tre) z. Orinaldo Aqif Rakipi, numri rendor 4 (katër) znj. Ogerta Dhionis Manastirliu, numri rendor 5 (pesë) z. Arben Nevruz Ahmetaj, numri rendor 6 (gjashtë) z. Ulsi Qerim Manja, numri rendor 7 (shtatë) znj. Etilda Dalip Gjonaj, numri rendor 8 (tetë) z. Arben Servet Pëllumbi, numri rendor 9 (nëntë) znj. Elisa Aleksander Spiropali, numri rendor 10 (dhjetë) znj. Belinda Çlirim Balluku, numri rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Toni Jorgaq Gogu, numri rendor 12 (dymbëdhjetë) z. Etjen Vullnet Xhafaj, numri rendor 13 (trembëdhjetë) znj. Ermonela Koço Valikaj, numri rendor 14 (katërmëdhjetë) z. Xhemal Myslym Qefalia, numri rendor 15 (pesëmbëdhjetë) z. Fatmir Sezai Xhafaj, numri rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë) znj. Klotilda Fatmir Bushka,

numri rendor 17 (shtatëmbëdhjetë) z. Alqi Edmond Bllako, numri rendor 18 (tetëmbëdhjetë) z. Eduard Pajtim Shalsi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Duke qenë se dorëheqja e znj. Najada Fatosh Çomo, ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163, pika 7, nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Neni 164, pika 2, parashikon: “Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të Këshillit të Bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar. Në këtë rast, plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listë të gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të të njëjtës gjini”.

Në këtë rast, plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës, i cili është i gjinisë “mashkull” do të ulte përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar dhe për këtë arsye zëvendësimi i kandidatit do të bëhet me kandidatin e radhës të gjinisë “femër”, të përcaktuar në vendimin nr. 409, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 20, (njëzet) znj. Mimi Pjetër Kodheli.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, znj. Mimi Pjetër Kodheli, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 1899 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin



e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Mimi Pjetër Kodheli, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit znj. Najada Fatosh Çomo, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 20, (njëzet) znj. Mimi Pjetër Kodheli.

#### PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””,

#### VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, znj. Mimi Pjetër Kodheli.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR  
I ZGJEDHJEVE  
Ilirjan Celibashi

#### VENDIM

Nr. 441, datë 10.9.2021

#### PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU DURRËS, Z. DENIS MEHMET DELIU

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

#### VËREJ:

Me shkresën nr. 1901/1 prot., datë 10.9.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes, të z. Lefter Haki Koka, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, qarku Durrës, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara më datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 408, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese,



në zonën zgjedhore qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021, ka fituar 8 (tetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Durrës, janë:

Numri rendor 1 (një) znj. Milva Vilson Ekonomi, numri rendor 2 (dy) z. Alban Viktor Xhelili, numri rendor 3 (tre) z. Jurgis Shefqet Qyrbja, numri rendor 4 (katër) znj. Klodiana Fatmir Spahiu, numri rendor 5 (pesë) z. Ilir Muhamet Ndraxhi, numri rendor 6 (gjashtë) z. Rrahman Rexhep Rrahja, numri rendor 7 (shtatë) z. Lefter Haki Koka, numri rendor 8 (tetë) z. Edi Kristaq Rama.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163, pika 7 dhe nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 408, datë 23.6.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 9, (nëntë) z. Denis Mehmet Deliu.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, z. Denis Mehmet Deliu, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 1673 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku

Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Denis Mehmet Deliu, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Denis Mehmet Deliu, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Lefter Haki Koka, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, i renditur me numër rendor 9, (nëntë) z. Denis Mehmet Deliu.

#### PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

#### VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Durrës, z. Denis Mehmet Deliu.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR  
I ZGJEDHJEVE  
**Ilirjan Celibashi**



**VENDIM**  
**Nr. 442, datë 10.9.2021**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË  
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË  
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË PARTISË  
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU  
FIER, ZNJ. MIRELA LLAMBRO PITUSHI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “Ë”, “n” e 2, 163 pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 1855/1 prot., datë 10.9.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes, të z. Gramoz Kaso Ruçi, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, qarku Fier, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara më datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 417, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirënditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese,

në zonën zgjedhore qarku Fier për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021, ka fituar 9 (nëntë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Fier, janë:

Numri rendor 1 (një) z. Erion Mirdash Braçe, numri rendor 2 (dy) z. Petro Vasil Koçi, numri rendor 3 (tre) znj. Lindita Izet Buxheli, numri rendor 4 (katër) z. Baftjar Mehmet Zeqaj, numri rendor 5 (pesë) znj. Antoneta Nasi Dhima, numri rendor 6 (gjashtë) z. Bujar Avdulla Çela, numri rendor 7 (shtatë) znj. Tatiana Nuredin Piro, numri rendor 8 (tetë) z. Gramoz Kaso Ruçi,

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163, pika 7 dhe nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 417, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 10, (dhjetë) znj. Mirela Llambro Pitushi.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, znj. Mirela Llambro Pitushi, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 1824 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se të dhënat e kandidatit për deputet, në



zonën zgjedhore, qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Mirela Llambro Pitushi, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Gramoz Kaso Ruçi, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore qarku Fier, i renditur me numër rendor 10, (dhjetë) znj. Mirela Llambro Pitushi.

#### PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””,

#### VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Fier, znj. Mirela Llambro Pitushi.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR  
I ZGJEDHJEVE  
**Ilirjan Celibashi**

#### VENDIM

Nr. 443, datë 10.9.2021

#### **PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR NDRYSHIM”, QARKU LEZHË, ZNJ. ELDA ARTAN HOTI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

#### VËREJ:

Me shkresën nr. 1880/1 prot., datë 10.9.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes të z. Mark Pjetër Marku, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore qarku Lezhë, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara më datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 414, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfutur



mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese, në zonën zgjedhore qarku Lezhë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, qarku Lezhë, janë:

numri rendor 1 (një) z. Mark Pjetër Marku, numri rendor 2 (dy) z. Agron Nikolle Gjekmarkaj, numri rendor 3 (tre) znj. Lindita Ilir Metaliaj, numri rendor 4 (katër) z. Kastriot Pren Piroli,

rezulton se lista shumemërore e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163, pika 7 dhe nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 414, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me rendor 5, (pesë) znj. Elda Artan Hoti.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, znj. Elda Artan Hoti, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2513 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Elda Artan Hoti, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin

e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Mark Pjetër Marku, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Lezhë, i renditur me numër rendor 5, (pesë) znj. Elda Artan Hoti.

#### PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

#### VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, znj. Elda Artan Hoti.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR  
I ZGJEDHJEVE  
**Ilirjan Celibashi**

#### VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 5 (1551), datë 8.7.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Gardelina Gafko, e datëlindjes 20.6.1969, si dhe caktimin si kujdestar dhe përfaqësues ligjor të saj shtetasin Erjan Gafko.



*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë